VENDIM
Nr. 693, datë 10.10.2012

PËR MIRATIMIN E GARANCISË QEVERITARE, QË LËSHOHET NË FAVOR TË RAIFFEISEN BANK SHA, ALBANIA DHE INTESA SANPAOLO SHA, ALBANIA, NË KUADËR TË KONTRATAVE PËRKATËSE NDËRMJET KËTYRE BANKAVE DHE KESH SHA

(Ndryshuar me Vendimin nr. 777 datë 16.11.2012)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 57 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", të ndryshuar dhe të nenit 3 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. *Miratimin e garancisë qeveritare, që lëshohet në favor të Raiffeisen Bank sh.a., Albania, në kuadër të kontratës së huas ndërmjet kësaj banke dhe KESH sh.a., për shumën ekuivalente, në lekë, të shumës 50 (pesëdhjetë) milionë euro.*

2. Shfuqizuar.

3. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha